



Tiranë, më 19.03.2026 nr. 508 prot.



Elbasan, më 19.03.2026, nr. 701 prot.

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË (ASHSH)

DHE

UNIVERSITETIT TË ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"

Hyrje

Bashkëpunimi do të ketë si fokus kryesor fushën e hulumtimeve dhe studimeve në kërkimin shkencor e në formimin universitar të brezave të rinj në gjithë fushat e dijes, në përputhje me strategjinë e hapjes ndaj bashkësive shkencore-universitare që ndiqet nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe me politikat bashkëpunuese të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,

Akademia e Shkencave e Shqipërisë (ASHSH), me qendër në Tiranë, sheshi Fan Noli, e përfaqësuar nga akad. Skënder Gjinushi, Kryetar dhe Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” (UE), me adresë: rruga “Ismail Zyma”, Elbasan, i përfaqësuar nga rektorja Prof. dr. Elvira Fetahu, bien dakord për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje sipas kushteve të mëposhtme:

Neni 1 **Objekti dhe qëllimi**

Objekti i kësaj marrëveshjeje është vendosja e një kuadri bashkëpunimi ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASHSH) dhe Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, duke përcaktuar mënyrat e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërmjet strukturave të tyre përbërëse. Ky bashkëpunim synon zhvillimin dhe zbatimin e aktiviteteve të përbashkëta me interes të ndërsjellë, në përputhje me misionin dhe funksionet institucionale të palëve, si dhe me legjislacionin në fuqi.

Neni 2 **Kuadri ligjor i bashkëpunimit**

1. Kjo marrëveshje bazohet në dispozitat e ligjit nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”; Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 109/2024 “Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në çdo akt tjetër ligjor dhe nënligjor të lidhur me arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.
2. Palët angazhohen që të respektojnë të gjitha rregulloret dhe aktet e brendshme të secilit institucion, si dhe të zbatojnë standardet dhe politikat e miratuara për menaxhimin dhe zhvillimin e aktiviteteve akademike dhe kërkimore-shkencore.
3. Çdo ndryshim në kuadrin ligjor ose rregullativ gjatë periudhës së vlefshmërisë së kësaj marrëveshjeje do të pasqyrohet dhe do të trajtohet nëpërmjet një aneksi përkatës, i cili do të nënshkruhet nga të dyja palët dhe do të bëhet pjesë përbërëse e marrëveshjes.

Neni 3

Parimet e bashkëpunimit

1. Bashkëpunimi ndërmjet palëve bazohet në parimet e barazisë, respektit të ndërsjellë, transparencës, autonomisë institucionale dhe përfitimit të përbashkët.
2. Palët angazhohen të respektojnë legjislacionin në fuqi, standardet akademike dhe shkencore, si dhe rregulloret e brendshme të secilit institucion gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje.
3. Në zbatimin e aktiviteteve të përbashkëta, palët respektojnë *Kodin evropian të sjelljes për integritet në kërkimin shkencor*, si dhe parimet e integritetit akademik, etikës në kërkimin shkencor dhe normat e sjelljes profesionale, duke përfshirë respektimin e parimeve kundër plagjiaturës dhe konfliktit të interesit”.

Neni 4

Angazhimi dhe bashkëpunimi akademik dhe shkencor

Akademia e Shkencave e Shqipërisë (ASHSH) dhe Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" angazhohen për një bashkëpunim të ngushtë dhe të qëndrueshëm, që ka për qëllim zhvillimin e aktiviteteve akademike, shkencore dhe kërkimore në nivele të larta, me synim forcimin e kapaciteteve të të dyja institucioneve. Bashkëpunimi do të realizohet përmes:

1. Organizimit të përbashkët të konferencave, seminareve, tryezave shkencore, simpoziumeve dhe aktiviteteve të tjera akademike dhe shkencore;
2. Zhvillimit dhe zbatimit të projekteve kërkimore dhe studimore me interes të përbashkët, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
3. Shkëmbimit të përvojës akademike dhe shkencore ndërmjet studiuesve, kërkuesve dhe stafit akademik, në funksion të zhvillimit të kapaciteteve profesionale dhe kërkimore;
4. Mbështetjes dhe promovimit të studiuesve të rinj, nëpërmjet përfshirjes në aktivitete kërkimore dhe shkencore;
5. Hartimit të studimeve, raporteve dhe dokumenteve strategjike me interes të përbashkët;
6. Shkëmbimit të informacionit shkencor, botimeve dhe materialeve akademike, në përputhje me rregullat përkatëse;
7. Bashkëpunimit në hartimin e strategjive të zhvillimit dhe të akteve normative në zbatim të tyre, në fusha me interes të përbashkët;
8. Organizimit të aktiviteteve për zhvillimin e kapaciteteve shkencore dhe profesionale;
9. Formave të tjera të bashkëpunimit të dakordësuara ndërmjet palëve, në përputhje me misionin dhe rregulloret e tyre të brendshme.

Neni 5

Bashkëpunime të veçanta

Përtej drejtimeve kryesore të bashkëpunimit, palët realizojnë dhe bashkëpunime të veçanta të cilat shtrihen kryesisht në:

1. Palët mbështesin organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta shkencore dhe akademike, sipas nevojës dhe interesit të ndërsjellë;

2. Akademia e Shkencave e Shqipërisë (ASHSH), në përputhje me procedurat dhe rregulloret e saj të brendshme, mbështet dhe, sipas rastit, mundëson përfshirjen e ekspertëve dhe studiuesve në aktivitete kërkimore dhe shkencore;
3. ASHSH mund të ftojë përfaqësues të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” për të marrë pjesë në veprimtari shkencore dhe akademike, sipas nevojës dhe mundësive;
4. Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” mbështet pjesëmarrjen e stafit akademik dhe kërkimor në aktivitetet e përbashkëta dhe nxit përfshirjen e tyre në bashkëpunime me ASHSH;
5. Palët bashkëpunojnë për përfshirjen e studiuesve dhe studentëve në aktivitete kërkimore dhe shkencore, në përputhje me rregulloret përkatëse;
6. Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” mund të propozojë ekspertë dhe studiues për përfshirje në aktivitete të përbashkëta me ASHSH, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregulloret në fuqi;
7. Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” mund të japë mendime, sugjerime ose rekomandime në procese me interes të përbashkët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e ASHSH;
8. Palët bashkëpunojnë në aktivitete kërkimore-shkencore dhe në zhvillimin e kapaciteteve kërkimore, pa cenuar autonominë institucionale dhe rolin e secilës palë;
9. Palët mbështesin shkëmbimin e informacionit dhe materialeve shkencore, në përputhje me rregullat përkatëse të aksesit dhe përdorimit;
10. Zbatimi i angazhimeve të parashikuara në këtë nen bëhet në përputhje me kapacitetet institucionale dhe burimet në dispozicion të secilës palë.
11. Njësitë bazë dhe Senati i UE marrin pjesë në procesin e promovimit të kandidatëve për anëtarë të Asamblesë së ASHSH, në zgjerim të traditave të mirënjohura të bashkëpunimit, siç parashikohet në ligjin dhe në Statutin e saj.
12. Përfaqësues të trupës akademike të UE përfshihen sipas fushave në komisionet e përhershme që funksionojnë pranë ASHSH. UE mirëpret inkurajon dhe mundëson pjesëmarrjen në këto komisione.

Neni 6

Përgjegjësitë ligjore dhe etike në zbatimin e marrëveshjes

1. Palët angazhohen për të respektuar të gjitha dispozitat ligjore dhe rregulloret në fuqi që lidhen me arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, duke siguruar që të gjitha aktivitetet të realizohen në përputhje me normat ligjore dhe etike që rregullojnë fushat përkatëse.
2. Palët do të angazhohen të trajtojnë çdo çështje dhe aktivitet, të lidhur me zbatimin e kësaj marrëveshjeje, me transparencë dhe ndershmëri. Çdo veprim do të realizohet duke respektuar parimet e drejtësisë, etikës dhe integritetit profesional.
3. Palët do të bashkëpunojnë për të parandaluar çdo formë të abuzimit, keqpërdorimit të burimeve, ose të veprimeve që mund të dëmtojnë integritetin e marrëveshjes. Çdo akt të tillë do të merret seriozisht dhe do të trajtohet sipas procedurave dhe sanksioneve të përcaktuara nga legjislacioni përkatës dhe rregulloret e brendshme të institucioneve.

Neni 7

Promovimi i bashkëpunimit

1. Palët bien dakord për promovimin e këtij bashkëpunimi përmes aktiviteteve publike dhe informuese, të tilla si konferenca, seminare dhe publikime në faqet zyrtare të UE-së dhe ASHSH.
2. Informacioni mbi aktivitetet dhe rezultatet e bashkëpunimit do të publikohet në mënyrë transparente dhe të aksesueshme.

Neni 8

Shkëmbimi i botimeve dhe i informacionit

1. Palët i sigurojnë njëra-tjetrës shkëmbimin e ndërsjellë dhe të pakushtëzuar të informacionit shkencor (katalogë, udhërrëfyes, bibliografi), të periodikëve që botojnë, të botimeve të digjitalizuara, të studimeve dhe monografive, etj.
2. Palët shkëmbejnë falas përmes procedurës së dhurimeve, botimet shkencore në përputhje me profilin dhe nevojat e bibliotekave të dy institucioneve.
3. Akademia e Shkencave e Shqipërisë (ASHSH), në përputhje me procedurat, kushtet teknike dhe administrative në fuqi, mbështet aksesin e stafit akademik dhe kërkimor të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” në sistemet dhe burimet e disponueshme kërkimore.
4. Aksesin në sisteme specifike, përfshirë platformat kombëtare dhe ndërkombëtare të informacionit shkencor, realizohet në përputhje me rregullat e administrimit dhe përdorimit të këtyre sistemeve.
5. Përdorimi i burimeve dhe sistemeve bëhet në përputhje me parimet e integritetit akademik, sigurisë së informacionit dhe mbrojtjes së të dhënave.
6. Pikë kontakti për komunikimin e vazhdueshëm në kuadër të realizimit të objektivave të kësaj marrëveshje do të jenë:
 - Për Akademinë e Shkencave: znj. Alma Bela, me detyrë specialiste e burimeve njerëzore dhe juriste, me adresë e-maili: alma.bela@akad.gov.al dhe nr. telefoni: +355 688541301.
 - Për Universitetin e Elbasanit: z. Ervis Sanço, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Koordinimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë, me adresë e-maili: ervis.sanco@uniel.edu.al dhe nr. telefoni: +355 688418729;
7. Palët informojnë rregullisht njëra-tjetrën për marrëveshjet dy ose shumëpalëshe me interes të ndërsjellë.
8. Palët shkëmbejnë ekspertiza dhe mbikëqyrje të përbashkëta të veprimtarisë shkencore në ekspedita dhe në kërkime.

Neni 9

Përdorimi i burimeve dhe infrastrukturës

1. Palët do të angazhohen për ndarjen dhe përdorimin e burimeve dhe infrastrukturës që mund të jenë të nevojshme për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta, si biblioteka, pajisje dhe teknologji.
2. Çdo përdorim i burimeve dhe infrastrukturës nga ana e palëve do të bëhet në përputhje me rregullat dhe procedurat e brendshme të secilës palë, duke siguruar që ato të shfrytëzohen në mënyrë efikase dhe të sigurt.

Neni 10

Efektet financiare

1. Palët marrin për sipër të mbulojnë shpenzimet financiare të lidhura me aktivitetet e bashkëpunimit, sipas burimeve të veta dhe projekt-marrëveshjeve specifike.
2. Çdo angazhim financiar do të formalizohet në dokumente të veçanta të miratuara nga palët.
3. Palët mund të bashkëpunojnë për aplikimin në projekte dhe programe financimi kombëtare dhe ndërkombëtare, në përputhje me interesat e tyre dhe rregullat përkatëse.
4. Menaxhimi i fondeve, në rast të projekteve të përbashkëta, rregullohet me marrëveshje specifike ndërmjet palëve.

Neni 11

Kohëzgjatja dhe përfundimi i Marrëveshjes

Kjo marrëveshje hyn në fuqi nga data e nënshkrimit dhe do të mbetet e vlefshme deri në momentin kur njëra palë të shprehë me shkrim vullnetin për ta përfunduar.

Ajo mund të rinovohet me marrëveshje të shkruar nga të dyja palët.

Secila palë ka të drejtë të zgjidhë këtë marrëveshje në mënyrë të njëanshme, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar palës tjetër, të paktën 3 (tre) muaj përpara datës së përfundimit.

Përfundimi i kësaj marrëveshjeje nuk ndikon në zbatimin e aktiviteteve apo projekteve të nisura gjatë kohëzgjatjes së saj, të cilat do të vijojnë deri në përfundimin e tyre, përveç rasteve kur palët bien dakord ndryshe me shkrim.

Neni 12

Ndryshimet dhe shtesat në Marrëveshje

1. Çdo ndryshim ose shtesë në këtë marrëveshje do të bëhet vetëm me pëlqimin e të dyja palëve dhe duhet të formalizohet me shkrim.
2. Çdo ndryshim, shtesë ose përmirësim i marrëveshjes do të konsiderohet si pjesë e saj dhe do të ketë të njëjtën fuqi ligjore si marrëveshja origjinale.
3. Ndryshimet ose shtesat në marrëveshje do të nënshkruhen nga përfaqësuesit e autorizuar të secilës palë dhe do të bëhen pjesë e marrëveshjes vetëm pasi të jenë miratuar dhe nënshkruar nga të dyja palët.

4. Palët do të angazhohen që çdo ndryshim të bëhet në mënyrë transparente dhe të dokumentuar, për të siguruar që të dyja palët janë në dijeni të angazhimeve të reja që lindin nga çdo modifikim.

Neni 13

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që lind nga interpretimi ose zbatimi i kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet nëpërmjet negociatave ndërmjet palëve. Në rast se mosmarrëveshja nuk zgjidhet, ajo do të trajtohet sipas legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

Kjo Marrëveshje është përgatitur në dy kopje origjinale, një për secilën palë, dhe ka fuqi të barabartë ligjore.

Për:

**AKADEMINË E SHKENCAVE
TË SHQIPËRISË**

Akademik Skënder Gjinushi

KRYETAR

**UNIVERSITETIN E ELBASANIT
"ALEKSANDËR XHUVANI"**

Prof. dr. Elvira Fetahu

REKTORI